



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:260210

Datë: 17.08.2023

Numri i dokumentit: 04592447

P.Nr.136/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Krimeve të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Rrahman Beqiri, me zyrtare ligjore Atdhetare Bashota Krasniqi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit: A.J, për shkak të veprës penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269, par.1, të KPRK - së, të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.I.nr. 3713/2019, të datës 31.08.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 14.07.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Shpëtim Peci dhe të akuzuarit A.J, më datë 17.07.2023, e shpalli publikisht, ndërsa më datën 17.08.2023, e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.J, nga i ati H..., e ëma H..., e gjinisë H..., lindur me data e lindjes..., në Vushtrri, ndërsa tani me vendbanim në Mitrovicë, Rr: "...", Nr: ..., me numër personal: ..., i papunë, i martuar, baba i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Më datë 28.10.2018, pa autorizim ka poseduar substanca narkotike të llojit heroinë, ku i njëjti në Mitrovicë, te "...", është ndalur nga policia ku është gjetur substancë narkotike prej 0.5 gram, e cila i është sekuestruar e që nga ekspertiza ka rezultuar që është heroinë të përzier me Acetaminofen (Paracetamol) dhe Kafeinë.

Me këtë ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269, par.1, të KPRK – së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 72, dhe nenit 269, par.1, të KPRK-së, dhe neneve 358, 361, 364, 365, 368, 369 dhe 449, të KPP - së, e:

GJYKON

1. Dënim me burg me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej një (1) viti nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi;
2. Dënim me gjobë në shumën prej 400 (katërqind) euro, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43, të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Konfiskohen në mënyrë të përhershme sendet, dhe atë:
 - a. Substanca narkotike prej 0.5 gram;
 - b. Urdhërohet Policia e Kosovës që substancën narkotike ta shkatërroj sipas procedurave ligjore në fuqi.
4. Obligohet i akuzuari, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50€, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Kërkesë pasurore - juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda ka ngritur Aktakuzën PP.I.nr. 3713/2019, të datës 31.08.2020, ndaj të pandehurve: M.K, për shkak të veprave penale: 1. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267, par.2, të KPRK – së; dhe 2. Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 366, par.1, të KPRK – së; dhe, A.J, për shkak të veprës penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269, par.1, të KPRK – së.

Sa i përket të akuzuarit M.K, Gjykata, në seancën e shqyrtimit fillestar, duke qenë se nuk e pranoi fajësisë e veçoj procedurën penale ndaj tij.

Ndryshe nga kjo, i akuzuari A.J, në seancën e shqyrtimit fillestar me datë 14.07.2023, e pranoi fajësinë në tërsi për veprën penale, sipas aktakuzës, duke theksuar se këtë substancë e ka pasur për posedim personal.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, prandaj, i propozoj gjykatës që të bëjë miratimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe këtë pranim ta marr parasysh si rrethanë lehtësuese me rastin e përcaktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242, të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, mbështetet edhe në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Raporti policor, i datës 28.10.2019, i hartuar nga B.Sh; Referenca e datës 29.10.2019, e hartuar nga M.T; UGJK.nr. 65/2019, e datës 28.10.2019; Procesverbali mbi kontrollin, i datës 28.10.2019; Lista e dëshmitëve, e datës 28.10.2019; Raporti nga shikimi i vendit të ngjarjes, i datës 28.09.2019, i hartuar nga A.N dhe M.L; Lista e gjërave të konfiskuara, e datës 28.10.2019; Raporti i ekspertizës së substancës narkotike ..., i datës 25.11.2019; Raporti i ekspertimit të telefonave ..., e datës 04.01.2020; si dhe fotodokumentacioni. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja se pas pranimit të fajësisë, nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari A.J, ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, nga neni 269, par.1, të KPRK - së, për të cilën veprë është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69, të KPRK-së.

Rrethana rënduese, Gjykata në rastin konkret nuk ka gjetur. Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, rrethanë kjo lehtësuese e përcaktuar nga vetë ligji, sipas nenit 71, par. 1.3 të KPRK-së, faktin se i njëjti ka shprehur keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rasti, gjendjen e dobët ekonomike, faktin se është i papunë.

Gjykata, sa i përket dënimit me burg, në kuptim të nenit 71, të KPRK-së, ka aplikuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke u bazuar në faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe se pranimi i fajësisë është rrethanë ligjore, në kuptim të nenit 71, par.1, nënpar.1.3, të KPRK-së, për zbutjen e dënimit, respektivisht që gjykata të shqiptojë dënim nën minimumin e dënimit të paraparë për këtë veprë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata të pandehurit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, i paraparë sipas nenit 38, të KPRK-së, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Gjykata, si në dispozitiv të Aktgjykimit ndaj të pandehurit, ka konfiskuar substancën narkotike, duke marrë për bazë sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende që janë rezultat i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet më lartë, në mbështetje të nenit 276, par.1, e lidhur me par.2,

nënp.2.4, të KPP-së, ku përcakton se kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale, nga nenet 267-274, të Kodit Penal, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marr parasysh gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, e lidhur me nenin 267, par.5, të KPRK-së, i cili përcakton se substanca narkotike konfiskohet, andaj për shkak të këtyre konstatimeve gjykata ka vendosur si në dispozitiv për konfiskimin e tyre.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450, par.2, pika 2.6, të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36, par.3, të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 462, të KPP-së, pasi që një kërkesë e tillë nuk ishte parashtruar.

Andaj, Gjykata, duke u bazuar me neni 364, 365 dhe 449, të KPP – së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Krimeve të Rënda
P.Nr. 136/2023, datë 17.08.2023
2019:260210, 17.08.2023

Zyrtare Ligjore:
Atdhetare Bashota Krasniqi

Kryetari i trupit gjykues

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij Aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.